




Skema e Investimeve,  
305 aplikime për  
mekanikë  
bujqësore

Faqe 12



Denaj: 4,4 miliardë  
lekë subvencionim  
fermerëve në vitin  
2025

Faqe 2



Demo: Vaji i ullirit  
i prodhuar në Berat  
eksportohet në  
Gjermani

Faqe 10



# AGROBIZNESI

Rr. "Qemal Stafa", P. 9-katësh,  
Nr. 70, Kati 2, Pazari i ri, Tiranë.  
Tel: +355 4 2 251 910 /911  
Email: info@fedinvest.al  
kontakt@fedinvest.al  
www.fedinvest.al

## BOTIM I KËSHILLIT TË AGROBIZNESIT SHQIPTAR

Adresa: Rruga "Mine Peza", Pallati 87/3, Hyrja 1, Kati i parë, Tel/ Fax: 2229445  
E-mail: infokash@yahoo.com www.kash.org.al

15-ditëshi i parë i muajit dhjetor 2024

Viti i shtatëmbëdhjetë i botimit - Nr. 499  
Çmimi 125 lekë

E përdyjavshme e pavarur

# INTEGRIMI EVROPIAN DHE RËNDËSIA E INFRASTRUKTURËS SË CILËSISË FORUMI I 2-TË KOMBËTAR I CILËSISË DHE STANDARDEVE: NJË HAP DREJT TË ARDHMES SË QËNDRUESHME PËR SHQIPËRINË

Forumi i 2-të Kombëtar i Cilësisë dhe Standardeve, një aktivitet madhor që mbledh liderë të shquar, vendimmarrës, ekspertë kombëtarë dhe ndërkombëtarë të industrisë dhe përfaqësues nga sektori publik dhe privat. Ky forum, me temën qendrore "Fuqizojmë Ndryshimin: Cilësi dhe Standarde për Njerëzit, Planetin dhe Prosperitetin," u organizua nga UNIDO, në bashkëpunim me SECO-n

**ALBANIA**  
Programi Global  
Për Cilësi dhe  
Standarde

UNIDO  
UNITED NATIONS  
INDUSTRIAL DEVELOPMENT ORGANIZATION

Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Sekretariati i Shtetit për Çështjet Ekonomike SECO



Tregtimi i bimëve  
medicinale, prodhimi  
i ulët rrit çmimin



Faqe 7

## LEGJISLACION

Mikrokreditë, Malaj:  
Shumë shpejt do të  
kemi një draft të kuadrit  
rregullator



Faqe 12



"Festa e Mandarinës", Kote: Nis projekti  
për vaditjen me presion në 2200 ha tokë,  
përmirëson rendimentin

Faqe 10

## TEMA TË DITËS

- Mazniku: Startup-et në Elbasan, zgjidhje inovatore për sfidat ekonomike dhe sociale të zonës Fq.2
- Sa ullishte jepen me qira në Shqipëri? - Shpopullimi i fshatrave, tokat kthehen në biznes Fq.2
- "Legalizimi i pronave, afati 2028 është i arritshëm" - Rama: Ndihmë nga teknologjia. Rusi: Vetëm 2.9% e kërkesave, të shqyrtuara Fq.6
- Të rinjtë, kundër "rrymës" në tregun e punës - BB: Vetëm 15% e të diplomuarve mbarojnë degët që kërkon biznesi Fq.6
- Patatja - një nga ushqimet më të shtrenjtë në Botë - Prof. As. Dr. Eqrem Meçollari Fq.13

## BUJQËSI

Ngrohja globale 'ka ndërhyrë'  
në punët e bujqësisë! Fermerët  
e mbjellin grurin në dhjetor,  
një muaj përtej afatit



Faqe 7

# Zbardhet projektligji për faljen e gjobave - Parashikohet edhe lehtësimi i procedurave dhe ulje e tarifave vendore

Projektligji i sjellë nga Partia Socialiste për faljen e gjobave të ndërtimit pa leje në zonat rurale shkaktoi debate të ashpra në seancën plenare të së enjtes, për faktin

tisë Socialiste, së bashku me anulimin e masave administrative të papaguara për periudhën në fjalë, projektligji parashikon edhe lehtësimin e procedurave dhe dokumen-

e pushtetit vendor, për të ulur kostot për banorët e zonave rurale.

Për realizimin e këtyre tre objektivave deputetët propozojnë që të ketë një ndarje të qartë mes tipologjisë së ndërtimit.

Në grupin e parë të objekteve bëjnë pjesë, ndërhyrjet në shtëpi banimi në zona rurale, zgjerim banese pa prishur strukturën bazë pavarësisht nga sipërfaqja. Në grupin e dytë të objekteve janë ndërhyrjet në stalla, serra, ambiente dhe magazina që nuk janë për qëllim banimi, por për pika grumbullimi, aktivitet bujqësor apo blegtoral.

Për te dy grupet e objekteve, grupi i punës ka bërë edhe propozimet për ndryshime në dy aktet nënligjore; në VKM 408/2015 "Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit" dhe VKM Nr. 283, datë 1.4.2015 për përcaktimin e tipave, rregullave, kriterëve dhe procedurave për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, në tokë bujqësore, e ndryshuar"



se do të shqyrtohej me procedurë të përspejtuar.

Por, përveç faljes së gjobave për periudhën 1 janar 2015-30 nëntor 2024, projektligji përcakton edhe disa objektiva të tjerë.

Sipas relacionit të depozituar në Kuvend nga grupi i punës së deputetëve të Par-

tacionit për një tipologji të caktuar ndërtimesh, që janë të domosdoshme për zonat rurale, sidomos përmirësimi i shtëpive të banimit, si dhe objektet që janë në shërbim të veprimtarisë bujqësore.

Gjithashtu, projektligji propozon edhe rishikimin e tarifave dhe taksave nga ana

# "Centrale energjetike brenda kullotave" - Hyn në fuqi ligji i ri, lejon zhvillimin e këtyre projekteve

Brenda fondit kullor do të lejohet ndërtimi i centraleve diellore dhe atyre të erës". Ligji i ri është publikuar në Fletoren Zyrtare, duke iu hapur rrugë zbatimit të tij.

Ndryshimet u bënë pas kërkesës së deputetes së Partisë Socialiste, Edona Bilali, që përmes një projektligji kërkoi lejimin e veprimtarive që lidhen me prodhimin e energjisë së rinovueshme e që deri më tani ishin të ndaluara për t'u zhvilluar brenda këtyre sipërfaqeve.

Sipas deputetes, ndryshimi i propozuar bazohet në kërkesat e bëra për ndërtimin e parqeve fotovoltaike dhe eolike në fondin kullor.

Ndërkaq, sipas variantit të miratuar sipërfaqe të caktuara dhe toka të fondit kullor mund të jepen në përdorim për të zhvilluar në to veprimtari shoqërore, shëndetësore, sportive e turistike dhe për

prodhimin e energjisë së rinovueshme.

Për lejimin e ushtrimit të veprimtarive që lidhen me prodhimin e energjisë së rino-

ton se në rastet kur në fondin kullor publik dhe privat janë miratuar vendimmarrjet të Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit për zhvillime



vueshme në fondin kullor shtetëror janë njësitë e qeverisjes vendore që do të ndjekin procedurat ligjore përkatëse për dhënie e së drejtës së përdorimit.

Paralelisht, ligji i ri përcak-

turistike, nuk ndiqet procedura e heqjes nga fondi kullor, por struktura e menaxhimit të pyjeve dhe kullotave bashkiake, pasi merr dijëni, bën azhurnimin kadastral në kadastrën e fondit kullor.

# Denaj: 4,4 miliardë lekë subvencionim fermerëve në vitin 2025

Qeveria ka shtuar fondet në mbështetje të fermerëve, për nxitjen e investimeve në ferma të prodhimit bujqësor.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Anila Denaj u shpreh në një intervistë televizive se, skemat e subvencioneve janë ato që prekin më shumë përfitues dhe zënë gati 40% të peshës në buxhetin e përgjithshëm të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Denaj tha se, financimi i drejtpërdrejtë i fermerëve, përmes subvencioneve në bujqësi edhe për vitin që vjen ka shënuar rritje.

"Me një fond prej 4.4 miliardë lekë, buxheti i vitit 2025 është rreth 1 miliard lekë më shumë

krahasuar me vitin 2024, ndërsa buxheti faktik në 2025 parashikon të shkojë në shifrën e 55 milionë eurove", u shpreh ministria.

Sipas saj, në buxhetin e vitit 2025 për Ministrinë e Bujqësisë

dhe Zhvillimit Rural, skema e subvencioneve do të mbështesë me prioritet sektorë të rëndësishëm të fushës ku përfshihet: prodhimi bujqësor; blegtoria, agroturizmi, mekanizimi etj.



# Mazniku: Startup-et në Elbasan, zgjidhje inovatore për sfidat ekonomike dhe sociale të zonës

Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor, Arbjan Mazniku në një takim në Elbasan me

vatore për sfidat ekonomike dhe sociale të zonës.

"Me talentin dhe kreativ-



të rinjtë e qytetit dhe ministren për Shtetin, Sipërmarrjen dhe klimën e Biznesit, Delina Ibrahimaj tha se startup-et e mbështetura nga qeveria kanë sjellë zgjidhje të spikatura ino-

vetin e tyre, të rinjtë shqiptarë kanë treguar që janë një potencial i jashtëzakonshëm jo vetëm për vendin tonë por edhe për të gjithë rajonin", tha Mazniku në një postim në rrjetet sociale.

Programi për mbështetje të kompanive startup dhe lehtësuesit e startup-eve nëpërmjet granteve dhe masave mbështetëse 2025 është krijuar nga qeveria shqiptare për të stimuluar sipërmarrjen inovative duke ofruar financim për kompanitë startup më prem-tuese shqiptare.

Financimi i dhënë nga qeveria shqiptare në kuadër të mbështetjes me grante 2025, do të mbulojë 100% të kostove totale të projektit për aplikantët fitues në fazën e parë; Faza e Ndërtimit të Konceptit; 85% të kostove për aplikantët fitues në fazën e dytë; Faza e Validimit dhe 75% të kostove për aplikantët në fazën e tretë; Faza e Zgjerimit dhe Ndërkombëtarizimit. Afati i implementimit të projekteve për vitin 2025 do të jetë afërsisht 9 muaj.

# Sa ullishte jepen me qira në Shqipëri? - Shpopullimi i fshatrave, tokat kthehen në biznes

Shpopullimi i fshatrave dhe emigrimi në rritje i kanë shtyrë fermerët që pasurinë e paluajtshme ta nxjerrin me qira, duke u përpjekur kështu ta vënë në funksion atë por edhe të marrin të ardhura.

Dhe nuk bëhet fjalë vetëm për toka djerrë apo pa produktivitet, por edhe për ullishte të cilat nxjerrin një shumë të konsiderueshme të ardhurash vjetore nëse u bëhet shërbimi siç duhet si dhe vreshta që po ashtu, përveçse shitjes direkte të produktit, përpunohen në verë, musht, raki.

Referuar portalit të fermerit, ku janë të listuara tokat bujqësore që jepen me qira në

të gjithë vendin, duket se një peshë të konsiderueshme zënë ullishtet dhe vreshtaria.

Konkretisht, në total janë 4379 parcela të listuara për qira, pjesën më të madhe e zënë tokat arë, rreth 2768 parcela duke qenë se për arsye të ndryshme, ku përfshihet emigrimi, janë lënë djerre dhe dhënia me qira u jep mundësi për të krijuar të ardhura fermerëve kudo që ndodhen.

Ndërkohë që numërohen 649 parcela me pemëtore, 482 parcela me vreshta dhe 412 ullishte me sipërfaqe të ndryshme të cilat janë në tregun e qiradhënies. Sa i takon ullishteve, shumica prej

tyre gjenden në Berat, Fushë-Krujë, Durrës, Kuçovë, Përmet dhe Vlorë. Ndërsa pjesa më e madhe e vreshtave gjenden në Berat, Kurbin, Lezhë, Përmet dhe Vlorë.

Së fundmi, ulliri është konsideruar si një ndër kultivarët më me përfitim për fermerët, duke qenë se kërkesa është orientuar drejt prodhimit vendas të vajit të ullirit dhe po ashtu, bumi turistik ka bërë që kjo kërkesë të jetë më e lartë. Nga ana tjetër janë hapur dyert edhe për eksport, kryesisht me Italinë. Këtë vit duket se ka një prodhim të mbarë dhe aktualisht çmimi i shitjes së vajit të ullirit varion në 700 lekë/litër.

## INTEGRIMI EVROPIAN DHE RËNDËSIA E INFRASTRUKTURËS SË CILËSISË

## FORUMI I 2-TË KOMBËTAR I CILËSISË DHE STANDARDEVE: NJË HAP DREJT TË ARDHMES SË QËNDRUESHME PËR SHQIPËRINË

Forumi i 2-të Kombëtar i Cilësisë dhe Standardeve, një aktivitet madhor që mbledh liderë të shquar, vendimmarrës, ekspertë kombëtarë dhe ndërkombëtarë të industrisë dhe përfaqësues nga sektori publik dhe privat. Ky forum, me temën qendrore “Fuqizojmë Ndryshimin: Cilësi dhe Standarde për Njerëzit, Planetin dhe Prosperitetin,” u organizua nga UNIDO, në bashkëpunim me SECO-n

Në datën 19 nëntor 2024, Tirana mirëpriti Forumin e 2-të Kombëtar të Cilësisë dhe Standardeve, një ngjarje madhore që bashkoi mbi 200 pjesëmarrës, përfshirë vendimmarrës, liderë të industrisë, përfaqësues të qeverisë dhe ekspertë ndërkombëtarë. Tema kryesore e këtij forumi, “Fuqizojmë dryshimin: Cilësi dhe Standarde për Njerëzit, Planetin dhe Prosperitetin,” ishte një thirrje për të avancuar zhvillimin e qëndrueshëm përmes përmbushjes së standardeve ndërkombëtare dhe forcimit të infrastrukturës së cilësisë.

Organizuar nga Organizata e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim Industrial (UNIDO), në bashkëpunim me Sekretariatit e Shtetit Zviceran për Çështjet Ekonomike (SECO), ky aktivitet u fokusua në rolin kyç që luajnë cilësia dhe standardet në mbështetjen e tregtisë, përmirësimin e eksporteve dhe përshtatjen me kërkesat e Bashkimit Evropian.

Diskutimet u organizuan në dy panele kryesore:

- Paneli 1:** “Infrastruktura e Cilësisë si Shtyllë e Zhvillimit të Qëndrueshëm”
- Paneli 2:** “Rritja e Tregtisë dhe Eksporteve: Plotësimi i Nevojave të Sektorit Privat”



Paneli 1. Infrastruktura e Cilësisë si Shtyllë e Zhvillimit të Qëndrueshëm



Paneli 2. Rritja e Tregtisë dhe Eksporteve: Plotësimi i Nevojave të Sektorit Privat

### Paneli 1: Infrastruktura e Cilësisë si Shtyllë për Zhvillim të Qëndrueshëm

1. Dr. Nigel Howard Croft - Autoritet Global për Menaxhimin e Cilësisë dhe Konformitetit

Dr. Croft, një figurë ndërkombëtare në fushën e menaxhimit të cilësisë, dha një mesazh të qartë mbi rëndësinë e standardeve dhe akreditimit për një ekonomi të integruar globalisht. Ai filloi duke përdorur një krahasim interesant, duke thënë se:

“Ashtu si në futboll ku ekzistojnë rregulla të qarta për lojtarët, edhe në tregtinë ndërkombëtare rregullat e përbashkëta janë thelbësore.”

Sipas Dr. Croft, për Shqipërinë është jetike të kuptojmë dhe të përmbushim rregullat ndërkombëtare ndërsa përparon drejt integrimit në BE. Ai theksoi se cilësia nuk ka të bëjë vetëm me produktet, por edhe me mënyrën se si ato prodhohen, duke përfshirë mjedisin e punës, cilësinë e jetës dhe trashëgiminë për gjeneratat e ardhshme.



Dr. Nigel Howard Croft, Autoritet Global për Menaxhimin e Cilësisë dhe Konformitetit

jenë të pranueshme në tregjet ndërkombëtare.

Ai përmendi gjithashtu katër fazat për krijimin e një kulture të cilësisë: Njohja – të mësosh rregullat dhe standardet; Transformimi i njohurive në qëndrim – krijimi i ndërgjegjësimit për cilësinë; Zhvillimi i sjelljes individuale – përfshirja e lidershit në këtë proces; Transformimi në sjellje grupore – një fazë e vështirë që kërkon kohë dhe përkushtim.

Dr. Croft përfundoi me një mesazh të fortë mbi qëndrueshmërinë, duke thënë se është një proces që fillon me cilësinë e produkteve, shërbimeve dhe mjedisit dhe përfshin përgjegjësinë për të ardhmen e shoqërisë.

### Digjitalizimi i Standardizimit: Një hap drejt BE-së

2. Znj. Kostanca Dedja – Drejtorja e Përgjithshme e Standardizimit (DPS)



Ms. Kostanca Dedja Drejtorja e Përgjithshme e Standardizimit (DPS)

dardeve, nga draftimi deri te publikimi.

- Pjesëmarrje e gjerë e aktorëve në përmirësimin e standardeve.
- Akses në kohë reale në informacionin e përditësuar për bizneset shqiptare.

Ajo shtoi se integrimi i bazës së të dhënave të DPS-së me sistemet evropiane dhe ndërkombëtare është një mundësi e rëndësishme për bizneset shqiptare për të përmbushur kërkesat e tregut dhe për të përshpejtuar procesin e përshtatjes me BE-në.

### Siguria Ushqimore dhe Rëndësia e Akreditimit

Znj. Jonida Boçi, Drejtoreshë e ISUV-it, ofroi një panoramë të

Dr. Croft theksoi se në sektorin agror-shqimor, disa kërkesa nuk janë të negociueshme, si përmbushja e kufizimeve për mbetjet e pesticideve në produkte. Këto nuk janë thjesht pritshmëri të konsumatorëve, por kërkesa ligjore të vendeve importuese. Për këtë arsye, Shqipëria duhet të zhvillojë laboratorë të akredituar ndërkombëtarisht, të pajisur me mjete të kalibruara dhe të besueshme, për të garantuar që matjet e tyre të

detajuar mbi rëndësinë e laboratorëve të akredituar dhe kontributin e ISUV-it në përmirësimin e sigurisë ushqimore në Shqipëri. Ajo e vendosi theksin te roli i ISUV-it si një institucion referencë për analizimin e produkteve që hyjnë në tregun shqiptar dhe të atyre që synojnë eksportin në Bashkimin Evropian.

Sipas znj. Boçi, ISUV është pjesë e një zinxhiri strategjik për mbrojtjen e konsumatorit dhe sigurimin e cilësisë së produkteve ushqimore, së bashku me AKU (Autoriteti Kombëtar i Ushqimit) dhe AKVMB (Agjencia Kombëtare e Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve). Ajo shpjegoi se për ISUV, akreditimi ka qenë një udhëtim i gjatë dhe sfidues, i cili ka filluar në vitin 2008, kur proceset e akreditimit sapo po fillonin në Shqipëri. Në atë kohë, ISUV nisi të përvetësonte kërkesat e standardit ISO 17025, që është standardi ndërkombëtar për kompetencën teknike të laboratorëve.

“Kur ne filluam këtë proces, akreditimi nuk ishte i njohur gjerësisht në Shqipëri, por ne e kuptuam se ishte thelbësor për të mbrojtur rezultatet tona dhe për të krijuar besim në proceset që kryenim,” tha znj. Boçi. Ajo shtoi se sot, 75% e punës së ISUV-it bazohet në standarde të njohura ndërkombëtarisht, gjë që garanton besueshmërinë dhe saktësinë e analizave të tyre.

Një ndër arritjet më të rëndësishme të ISUV-it, të përmendura nga znj. Boçi, është akreditimi i analizave për grupin 6 sipas SANTE, që përfshin bimët aromatike dhe medicinale. Ky proces pritet të përfundojë brenda këtij viti dhe do të ketë një ndikim të madh në mundësitë e eksportit të këtyre produkteve. Një tjetër projekt i rëndësishëm është akreditimi për 250 pesticide në bimët medicinale, i cili është një hap i domosdoshëm për përmbushjen e standardit të BE-së për mbetjet e pesticideve në produkte.

Znj. Boçi theksoi se zbatimi i rregullore të BE-së për pesticidet duhet të përshtatet me realitetin shqiptar, duke marrë parasysh gjendjen aktuale të përdorimit të pesticideve dhe gjurmueshmërinë e mbetjeve në tokat bujqësore. Ajo tha:

“Për të garantuar një produkt të sigurt dhe të pranueshëm në tregjet ndërkombëtare, ne duhet të fillojmë me disiplinën dhe kujdesin që nga fusha deri në momentin e daljes së produktit në treg.”

Në fund të fjalës së saj, znj. Boçi theksoi se forume si ky janë thelbësore për të kuptuar më mirë sfidat dhe nevojat e biznesit privat. Ajo bëri thirrje për më shumë mbështetje me burime financiare dhe njerëzore për ISUV-in dhe institucione të tjera të ngjashme, në mënyrë që të garantohet siguria ushqimore dhe të përmirësohen mundësitë për eksport.

### Akreditimi dhe Besueshmëria Ndërkombëtare

Znj. Pranvera Fagu, Drejtoreshë e Përgjithshme e Akreditimit (DPA), theksoi rëndësinë e akreditimit si një proces kyç për përmbushjen e kërkesave ndërkombëtare dhe për garantimin e cilësisë së produkteve shqiptare. Ajo sqaroi se akreditimi është elementi që krijon besueshmëri dhe siguri, duke

# Forumi i 2-të Kombëtar i Cilësisë dhe Standardeve: Një hap drejt të ardhmes së qëndrueshme për Shqipërinë

(Vijon nga faqja 3)

siguruar që produktet dhe shërbimet të përmbushin standardet ndërkombëtare dhe të mund të pranohen pa vonesa në tregjet globale.

“Në jetën e përditshme si konsumatorë, ne gjithmonë pyesim nëse një produkt përputhet me standardet. Përgjigjen për këtë pyetje na e jep akreditimi,” u shpreh znj. Fagu.

Një ndër sukseset më të mëdha të DPA-së, të përmendur nga znj. Fagu, është anëtarësimi në organizata ndërkombëtare të akreditimit, si European co-operation for Accreditation (EA) dhe International Accreditation Forum (IAF). Këto anëtarësime garantojnë njohjen reciproke të akreditimeve të lëshuara në Shqipëri me ato të vendeve të tjera anëtare, duke i dhënë siguri bizneseve shqiptare për eksportet e tyre.

Znj. Fagu theksoi se akreditimi është një proces dinamik dhe afatgjatë që kërkon monitorim të vazhdueshëm për të ruajtur standardet e cilësisë. Çdo organizatë e akredituar duhet të kalojë vlerësime periodike për të konfirmuar përputhshmërinë e vazhdueshme me kërkesat ndërkombëtare.

Ajo përmendi se për dy vite me radhë, DPA ka punuar për të hapur skemën e certifikimit të GlobalG.A.P, një standard kyç për prodhuesit bujqësorë që duan të eksportojnë produktet e tyre në tregjet evropiane. Kjo skemë do të ndihmojë bizneset të dëshmojnë aftësinë e tyre për të përmbushur kërkesat e tregut ndërkombëtar, duke rritur kështu eksportet dhe fuqizuar sektorin privat.

Në përfundim, znj. Fagu u shpreh se akreditimi është një nga shtyllat kryesore për të forcuar infrastrukturën e cilësisë në Shqipëri. Ajo theksoi:

“Kur flasim për besueshmëri, flasim për garantim që ofron akreditimi – një proces rigoroz dhe i vazhdueshëm që siguron cilësi dhe përputhshmëri.”

Znj. Fagu bëri thirrje për bashkëpunim të ngushtë ndërmjet institucioneve shqiptare dhe për mbështetje të bizneseve në rrugën drejt përmbushjes së standardeve ndërkombëtare, duke hapur rrugën për një treg më të besueshëm dhe të qëndrueshëm.

## Bujqësia Organike dhe Certifikimi



Ms. Klodiana Balla, Biolnspecta

Znj. Klodiana Balla, përfaqësuese e BioInspecta, një trupë inspektuese dhe certifikuese e specializuar në certifikimin organik, ndau përvojën e gjatë dhe sfidat që sektori i bujqësisë organike ka hasur në Shqipëri. Me një përvojë prej 20 vitesh, Biolnspecta ka qenë një partner kyç në mbështetjen e fermerëve shqiptarë për të arritur certifikimin dhe për të përmbushur kërkesat ndërkombëtare.

Znj. Balla theksoi se zhvillimi i bujqësisë organike në Shqipëri ka ndjekur një trajektore të ngadaltë por të qëndrueshme. Sidoqoftë, sektori vazhdon të përballet me sfida të shumta, të cilat përfshijnë mungesën e laboratorëve të akredituar për analiza të produkteve organike dhe mungesën e kapaciteteve teknike për të përmbushur kërkesat e blerësve ndërkombëtarë.

“Bujqësia organike nuk mund të ekzistojë pa certifikim të rregullt dhe të njohur ndërkombëtarisht. Ne shpesh përballemi me produkte që pretendohen si organike, por vetëm certifikimi nga një trup i autorizuar dhe i akredituar mund të dëshmojë këtë cilësi,” tha znj. Balla. Ajo nënvizoi se produkte të pacertifikuara, pavarësisht pretendimeve, nuk mund të eksportohen apo të konsiderohen organike në tregjet e BE-

së apo të tjera ndërkombëtare.

Një nga pikat kyçe të diskutimit ishte mungesa e laboratorëve vendas të besueshëm për analizën e mbetjeve të pesticideve dhe cilësinë e produkteve organike. Kërkesat e blerësve shpesh diktojnë që analizat të kryhen në laboratorë të njohur ndërkombëtarisht, të cilët nuk ekzistojnë ende në Shqipëri. Kjo gjë, sipas znj. Balla, rrit ndjeshëm kostot për bizneset shqiptare, të cilat shpesh detyrohen të përdorin laboratorë jashtë vendit për të përmbushur kërkesat e eksportit.

“Ka ardhur koha që Shqipëria të investojë në laboratorë të akredituar, të aftë për të kryer analizat e kërkuara nga tregjet ndërkombëtare. Ky hap do të ulte ndjeshëm kostot për fermerët dhe bizneset, duke i bërë produktet shqiptare më konkurruese,” theksoi ajo.

Në vijim, znj. Balla shpjegoi se Biolnspecta mbështet fermat dhe bizneset duke ofruar certifikime të shumëfishta përmes një inspektimi të vetëm, i cili përshtatet me kërkesat e blerësve. Aktualisht, organizata ofron certifikim sipas:

- Ligjit shqiptar për bujqësinë organike për tregun vendas,
- Rregulloret e BE-së,
- Standardeve të tjera ndërkombëtare si ato të SHBA-ve, Zvicrës, Mbretërisë së Bashkuar dhe Kanadasë, varësisht nga kërkesat e klientëve.

Ajo shtoi se ndryshimet në rregulloret ndërkombëtare shpesh krijojnë paqartësi për fermerët shqiptarë, të cilët kanë nevojë për trajnime dhe informacion të përditësuar. Për këtë arsye, Biolnspecta organizon rregullisht sesione informuese për të ndihmuar fermerët të kuptojnë dhe të zbatojnë kërkesat e reja.

## Filip Gjoka – Shoqata e Bimëve Aromatike dhe Medicinale



Mr. Filip Gjoka – Shoqata e Bimëve Aromatike dhe Medicinale

tregjet globale.

Në fjalën e tij, z. Gjoka ngriti shqetësimin për mungesën e një laboratorit të akredituar në Shqipëri, që do të ishte një gjendje të kryente analizat për mbetjet e pesticideve sipas standardeve të kërkuara nga tregjet ndërkombëtare, veçanërisht ato të Bashkimit Evropian. Ai sqaroi se mungesa e një infrastrukture të tillë krijon pengesa të mëdha për eksportuesit shqiptarë të produkteve BAM, të cilët shpesh përballen me vonesa dhe kosto shtesë për kryerjen e analizave në laboratorë jashtë vendit.

“Për të rritur cilësinë dhe konkurrueshmërinë e produkteve tona, është urgjente krijimi i një laboratorit të akredituar brenda vendit. Ky laborator do të mundësonte analizimin e mbetjeve të pesticideve, duke përmbushur kërkesat e blerësve ndërkombëtarë dhe duke i hapur rrugë eksporteve të sigurt dhe të qëndrueshme,” u shpreh z. Gjoka.

Ai vuri theksin se sektori i bimëve aromatike dhe medicinale është një aset i rëndësishëm ekonomik për Shqipërinë, me potencial të madh për zhvillim dhe rritje në tregjet ndërkombëtare. Sipas tij, Shqipëria gëzon avantazhe natyrore për kultivimin dhe mbledhjen e këtyre bimëve, por për të përfutur plotësisht nga ky potencial, është e nevojshme që produktet të përmbushin standardet e cilësisë që kërkohen në tregjet e zhvilluara.

Z. Gjoka gjithashtu theksoi se një laborator i akredituar nuk do të përmirësonte vetëm cilësinë e produkteve BAM, por edhe do të ulte kostot për prodhuesit dhe eksportuesit, duke eliminuar varësinë nga laboratorët jashtë vendit. Ai e përshkroi këtë si një hap kyç për hapjen e tregjeve të reja dhe për sigurimin e besueshmërisë së produkteve shqiptare në sytë e blerësve ndërkombëtarë.

“Ne kemi nevojë për mbështetje konkrete për ngritjen e infrastrukturës së duhur për të analizuar dhe certifikuar produktet tona sipas standardeve ndërkombëtare. Vetëm në këtë mënyrë mund të garantojmë eksport të sigurt dhe të rrisim pjesën tonë në tregjet globale,” përfundoi z. Gjoka.

Mesazhi i tij ishte një thirrje e qartë për të bashkuar përpjekjet midis qeverisë, institucioneve publike dhe sektorit privat për të krijuar kapacitetet e nevojshme teknike dhe infrastrukturore. Ai nënvizoi se zhvillimi i këtij sektori, i mbështetur nga standarde të njohura ndërkombëtarisht dhe nga analiza të besueshme, do të kontribuonte në rritjen ekonomike dhe në përmirësimin e imazhit të Shqipërisë si një furnizues i besueshëm në tregjet globale të bimëve aromatike dhe medicinale.

## Panel II: Rritja e Tregtisë dhe Eksporteve – Plotësimi i Nevojave të Sektorit Privat

Paneli i dytë i Forumit të 2-të Kombëtar të Cilësisë dhe Standardeve u përqendrua te roli i sektorit privat në rritjen e tregtisë dhe eksporteve, duke adresuar nevojat e bizneseve për të qenë më konkurrues në tregjet ndërkombëtare.

### Z. Sokol Duma – Zëvendësministër, Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI)

Në fjalën e tij, z. Sokol Duma, Zëvendësministër në Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, theksoi përpjekjet e vazhdueshme të qeverisë shqiptare për të mbështetur sektorin privat dhe për të nxitur rritjen e eksporteve. Ai vuri në dukje se qasja e MEKI-së është e ndërtuar mbi parimin e krijimit të ekonomive kreative, duke përfshirë masa që nxisin inovacionin, përmirësojnë kapacitetet teknike dhe mbështesin ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM).

Një nga arritjet më të mëdha të Shqipërisë në vitet e fundit është rritja e ndjeshme e eksporteve, të cilat janë dyfishuar nga 2.5 miliardë euro në vitin 2018 në mbi 5 miliardë euro në vitin 2023, me një synim ambicioz prej 8 miliardë euro në vit. Kjo rritje ka ardhur si rezultat i përmirësimeve teknike dhe lehtësimit të tregtisë, të cilat kanë ndikuar drejtpërdrejt në uljen e kostove dhe kohës për eksportuesit shqiptarë.

Një element kyç që ka kontribuar në këtë sukses është pjesëmarrja e Shqipërisë në Tregun e Përbashkët Rajonal një nismë e prezantuar në Samitin e Sofjes më 2020. Ky treg, i modeluar sipas Tregut Unik Evropian, synon të forcojë integrimin ekonomik midis vendeve të Ballkanit Perëndimor. Z. Duma theksoi se kjo iniciativë ka:

- Rritur shkëmbimet tregtare,
- Tërhequr investitorë të huaj, dhe
- Krijuar mundësi të reja për eksportuesit shqiptarë.

Po ashtu, anëtarësimi i Shqipërisë në Marrëveshjen e Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore (CEFTA) që prej vitit 2013 ka dhënë rezultate pozitive. Vetëm në vitin 2023, eksportet drejt vendeve anëtare të CEFTA-s u rritën me 8%, duke përfaqësuar 18.1% të totalit të eksporteve shqiptare për atë vit.

Z. Duma theksoi rëndësinë e modernizimit të procedurave doganore për të lehtësuar tregtinë ndërkombëtare. Inovacioni dhe digitalizimi kanë bërë të mundur shkurtimin e kohës dhe kostove për import-eksport, duke krijuar një mjedis më të favorshëm për bizneset shqiptare.

Në mbështetje të sektorit privat, MEKI ka ofruar grante për të fuqizuar kapacitetet e NVM-ve dhe për të përmirësuar infrastrukturën e tyre teknologjike. Këto investime synojnë të rrisin produktivitetin dhe të përmirësojnë cilësinë e produkteve shqiptare, duke i bërë ato më tërheqëse për tregjet evropiane dhe globale.

Z. Duma theksoi se për të pasur sukses në tregun e Bashkimit Evropian, është e domosdoshme që sektori privat të jetë proaktiv dhe i gatshëm të përshtatet me kërkesat e tregut ndërkombëtar. Ai tha:



Mr. Sokol Duma - Zëvendësministër, Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI)

# Forumi i 2-të Kombëtar i Cilësisë dhe Standardeve: Një hap drejt të ardhmes së qëndrueshme për Shqipërinë

(Vijon nga faqja 4)

“Bashkimi Evropian është mbi të gjitha një union ekonomik dhe suksesi i Shqipërisë në këtë kontekst varet nga aftësia jonë për të krijuar produkte konkurruese dhe të përshtatura për tregun evropian.”

Në përmbajtje të fjalës së tij, z. Duma nënvizoi se mbështetja nga qeveria, përmes politikave të favorshme dhe investimeve strategjike, ka krijuar një bazë të fortë për eksportuesit shqiptarë. Megjithatë, sukseset e ardhshme varen nga angazhimi aktiv i sektorit privat për të rritur cilësinë, për të përmbushur standardet ndërkombëtare dhe për të shfrytëzuar mundësitë që ofrojnë tregjet globale.

Ky bashkëpunim midis qeverisë dhe biznesit është kyç për realizimin e synimit ambicioz të Shqipërisë për të arritur eksportet në vlerën 8 miliardë euro dhe për të siguruar një zhvillim ekonomik të qëndrueshëm.

## Znj. Ermira Gjeci – Shefe e Kabinetit, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MoARD)



Ms. Ermira Gjeci - Shefe e Kabinetit, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MoARD)

Znj. Ermira Gjeci, në emër të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MoARD), theksoi se bujqësia është një sektor jetik për ekonominë shqiptare, duke përfaqësuar 20% të PBB-së dhe duke treguar rritje të konsiderueshme të eksporteve. Sipas saj, vetëm në 10 muajt e fundit, volumi i eksporteve bujqësore është rritur me 90% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Objektivi ambicioz i qeverisë shqiptare për të arritur 1 miliardë dollarë në eksporte bujqësore deri në vitin 2030 mbetet një sfidë që kërkon përpjekje të mëdha në disa drejtime kryesore.

Ajo përmendi dy shtylla kryesore të strategjisë për përmirësimin e konkurrueshmërisë në sektorin bujqësor:

**1. Harmonizimi i Politikave dhe Legjislacionit me BE-në**  
Ministria është duke punuar punuar intensivisht për të përafuar legjislacionin me acquis të Bashkimit Evropian, duke u fokusuar në tre kapituj kryesorë:

- o Kapitulli 11 – Bujqësia dhe Zhvillimi Rural,
- o Kapitulli 12 – Siguria Ushqimore, Politikat Veterinare dhe Fitosanitare,
- o Kapitulli 13 – Peshkimi.

Në këtë drejtim, përpjekjet për përmirësimin e rregulloreve dhe procedurave janë thelbësore për të siguruar që Shqipëria të jetë konkurruese në tregun evropian. Anëtarësimi në Organizatën Botërore të Tregtisë (WTO) që nga viti 2000 ka ndikuar gjithashtu në adoptimin e standardeve ndërkombëtare.

**2. Mbështetja Financiare për Fermerët dhe Prodhuesit**

Znj. Gjeci shpjegoi se qeveria shqiptare, në bashkëpunim me donatorë ndërkombëtarë, siguron mbështetje financiare vjetore për fermerët, duke u fokusuar në investime që krijojnë vlerë të shtuar. Një nga risitë kryesore është përfshirja e masave për mbrojtjen nga ndryshimet klimatike, si p.sh.:

- Investimet në rrjeta mbrojtëse kundër breshërit për pemët frutore, vreshtat dhe agrumet.
- Skema e financimit për këtë masë përfshin 30% disburim paraprak deri në fund të vitit 2024.

Në të njëjtën kohë, investimet në infrastrukturën bujqësore po planifikohen për përmirësimin e kanaleve të ujitjes, sistemeve të kullimit dhe dambave mbrojtëse kundër përmblyjeve. Agroturizmi u identifikua si një tjetër sektor me potencial të madh për të rigjallëruar zonat rurale, duke lidhur prodhimin bujqësor me zhvillimin ekonomik dhe social të komuniteteve. Përmirësimi i sigurisë ushqimore mbetet një prioritet, ku përfshihen certifikimi i produkteve, përmirësimi i metodave të kontrollit dhe akreditimi i laboratorëve. Znj. Gjeci përmendi se janë ndarë 20 milionë euro për përmirësimin e laboratorëve në pikat e inspektimit kufitar.

Ajo gjithashtu theksoi rëndësinë e ligjit të ri të inspektimeve, i cili synon të angazhojë fermerët dhe prodhuesit në zbatimin e legjislacionit, jo përmes masave ndëshkuese, por përmes ndërgjegjësimit për përfitimet e përputhshmërisë me standardet.

“Ne kemi bërë progres të madh, por për të përmbushur objektivin tonë të eksporteve dhe për të rritur konkurrueshmërinë, kërkohet më shumë punë dhe përpjekje të përbashkëta,” përfundoi znj. Gjeci.

## Përfaqësuesi i Universitetit Bujqësor të Tiranës – Dr. Edvin Zhllima



Dr. Edvin Zhllima - Përfaqësuesi i Universitetit Bujqësor të Tiranës,

Përfaqësuesi i Universitetit Bujqësor të Tiranës, Dr. Edvin Zhllima trajtoi ndikimin e ndryshimeve klimatike në sektorin agroushqimor dhe rolin që standardet e cilësisë mund të luajnë në përshtatjen e fermerëve dhe prodhuesve ndaj këtyre sfidave. Ai theksoi se ndryshimet klimatike, si ngrohja globale, mungesa e ujit dhe stuhitë ekstreme, kanë ndikuar ndjeshëm në prodhimin bujqësor dhe kanë rritur kostot për fermerët shqiptarë.

Përmirësimi i cilësisë së produkteve përmes standardeve të njohura ndërkombëtarisht, si GlobalG.A.P., mund të ndihmojë fermerët të:

- Reduktojnë humbjet nga ndikimet klimatike,
- Sigurojnë produkte më të sigurta për tregjet ndërkombëtare, dhe
- Përfitojnë akses më të lehtë në mbështetje financiare dhe investime.

## Z. Agim Rrapaj – Kryetar i Këshillit të Agrobiznesit Shqiptar (KASH)

Z. Agim Rrapaj, Kryetar i Këshillit të Agrobiznesit Shqiptar (KASH), dha një pasqyrë të plotë mbi rolin strategjik që luan KASH në përfaqësimin e interesave të fermerëve, NVM-ve dhe aktorëve të tjerë në sektorin bujqësor. Ai e konsideroi bashkëpunimin midis aktorëve lokalë, sektorit privat dhe institucioneve qeveritare si një parakusht për fuqizimin e sektorit agroushqimor dhe për përmbushjen e standardeve ndërkombëtare.



Mr. Agim Rrapaj - Kryetar i Këshillit të Agrobiznesit Shqiptar (KASH)

Z. Rrapaj theksoi se KASH ka shërbyer si një zë i fuqishëm për fermerët shqiptarë, duke i përfaqësuar ata në tryezat e politikëbërjes dhe duke i ndihmuar të adresojnë sfidat që pengojnë zhvillimin e sektorit. Ai foli për nevojën për të krijuar një dialog të vazhdueshëm midis sektorit publik dhe privat për të siguruar që politikat dhe strategjitë të përputhen me realitetin në terren dhe me nevojat e fermerëve.

Një nga temat kryesore të fjalës së tij ishte rëndësia e zbatimit të standardeve të cilësisë në mënyrë të koordinuar dhe të mbështetur. Ai shpjegoi se për të përmbushur kërkesat e tregjeve ndërkombëtare, Shqipëria duhet të rrisë bashkëpunimin midis fermerëve, institucioneve mbështetëse dhe sektorit privat, duke përfshirë në këtë proces të gjithë aktorët e zinxhirit të vlerës.

“Pa një bashkëveprim të fortë dhe të organizuar midis fermerëve, institucioneve qeveritare dhe organizatave të sektorit privat, është e pamundur të garantojmë cilësinë dhe qëndrueshmërinë që kërkon tregu ndërkombëtar,” tha z. Rrapaj. Ai theksoi se një nga misionet kryesore të KASH është të ndihmojë fermerët dhe NVM-të të adoptojnë praktika të qëndrueshme që janë në përputhje me standardet ndërkombëtare, si GlobalG.A.P., ISO dhe certifikimet organike.

Një tjetër pikë kyçe ishte forcimi i kooperativave dhe organizatave të fermerëve. Z. Rrapaj argumentoi se organizimi në grupe apo kooperativa është një zgjidhje efektive për të

përmirësuar aksesin e fermerëve në tregje, për të ulur kostot dhe për të rritur kapacitetet për investime në teknologji moderne dhe praktika të qëndrueshme.

Për të adresuar këto sfida, z. Rrapaj bëri thirrje për një platformë bashkëpunimi të vazhdueshëm, ku sektorët publik dhe privatë të punojnë së bashku për të krijuar politika dhe mbështetje financiare që synojnë përmirësimin e konkurrueshmërisë së produkteve shqiptare në tregun ndërkombëtar. Ai e përmbylli fjalën e tij me një thirrje për mbështetje të organizuar të fermerëve dhe biznesit bujqësor:

“Ne kemi një potencial të jashtëzakonshëm në sektorin bujqësor, por ai nuk mund të realizohet pa një infrastrukturë të qëndrueshme dhe bashkëpunim të sinqertë midis të gjithë aktorëve. Vetëm kështu mund të arrijmë cilësinë e kërkuar dhe të hapim rrugën për eksportet shqiptare në tregjet më të zhvilluara.”

## Znj. Ana Shurdha – Grupi Vendor i Veprimit, Rajoni i Shkodrës

Znj. Ana Shurdha, përfaqësuese e Grupit Vendor të Veprimit në rajonin e Shkodrës, diskutoi mbi rolin vendimtar të qasjeve të drejtuara nga komuniteti në përmirësimin e cilësisë dhe qëndrueshmërisë së bujqësisë në zonat rurale.

Ajo theksoi se zhvillimi i një bashkëpunimi të ngushtë midis fermerëve, qeverisjes vendore dhe sektorit privat është çelësi për të adresuar sfidat me të cilat përballen zonat rurale. Sipas znj. Shurdha, një nga sfidat më të mëdha në zbatimin e standardeve të cilësisë në zonat rurale është mungesa e informacionit dhe kapaciteteve teknike për të përmbushur kërkesat e tregut. Fermerët, shpeshherë të paorganizuar dhe me mungesë të mjeteve financiare, hasin vështirësi në adoptimin e praktikave moderne dhe në përfitimin e certifikimeve ndërkombëtare.

“Fermerët në zonat rurale kanë potencial të madh, por për të siguruar zhvillim të qëndrueshëm, nevojitet një mbështetje më e madhe përmes investimeve në infrastrukturë dhe informimit të vazhdueshëm,” u shpreh znj. Shurdha. Znj. Shurdha përmendi se qasjet e drejtuara nga komuniteti janë më të efektshme, pasi përfshijnë fermerët dhe komunitetet lokale në procesin e zhvillimit, duke krijuar një ndjenjë përgjegjësie dhe pronësie mbi projektet. Në përfundim, ajo theksoi se bashkëpunimi dhe shkëmbimi i njohurive ndërmjet fermerëve dhe aktorëve institucionale është i domosdoshëm për të siguruar përmbushjen e standardeve ndërkombëtare dhe për të ndërtuar një bujqësi të qëndrueshme në Shqipëri.

“Qasja komunitare është e vetmja rrugë për të krijuar bujqësi të qëndrueshme dhe për të garantuar produkte cilësore që plotësojnë standardet ndërkombëtare,” përfundoi znj. Shurdha.

## Përfundim

Forumi dëshmoi se për të përmirësuar konkurrueshmërinë dhe për të siguruar zhvillim të qëndrueshëm, Shqipëria duhet të ndërtojë një ekosistem funksional të cilësisë dhe standardeve. Kjo përfshin:

- Modernizimin e infrastrukturës teknike, përfshirë laboratorët dhe mekanizmat e certifikimit,
- Mbështetjen e sektorit privat përmes financimeve dhe trajtimeve të barabarta në treg,
- Përfshirjen e komuniteteve lokale në projekte zhvillimi për të garantuar që përfitimet shtrihen në çdo pjesë të vendit.

Cilësia dhe standardet janë më shumë se një kërkesë teknike; ato përfaqësojnë rrugën drejt një ekonomie të qëndrueshme që mbështet eksportet shqiptare, nxit inovacionin dhe përgatit vendin për integrimin e plotë në Bashkimin Evropian. Bashkëpunimi ndërmjet qeverisë, sektorit privat dhe komuniteteve rurale do të jetë faktori përcaktues për suksesin e këtij qëllimi.

Në këtë kontekst, ky forum shërbeu si një platformë kritike dialogu dhe hodhi bazat për veprime të koordinuara që do të ndihmojnë Shqipërinë të bëhet një konkurrent i fortë në tregjet ndërkombëtare.



Ms. Ana Shurdha - Grupi Vendor i Veprimit, Rajoni i Shkodrës

## AKTUALITET

## Universiteti Bujqësor i Tiranës programe akademike sipas modelit të Universitetit të Vjenës BOKU

Më datë 6 Dhjetor 2024, Senati Akademik i UBT, në mbledhjen e tij të radhës, i hap rrugë krijimit dhe miratimit të Komisionit të Studimeve në nivel universitar.

Ky komision, i përbërë nga

profesorë, kërkues shkencorë dhe studentë nga Universiteti Bujqësor i Tiranës dhe Universiteti BOKU i Vjenës, përfaqëson një hap transformues në qeverisjen akademike. Ai synon të nxisë inovacionin në

zhvillimin e kurrikulave drejt një qasjeje ndër-disiplinore, duke siguruar përputhjen me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare.

Frymëzuar nga modeli i Universitetit të Shkencave të Burimeve Natyrore dhe të Jetës, Vjenë (BOKU), kjo iniciativë garanton përafrimin e programeve akademike të UBT-së me Strategjinë Kombëtare të Arsimit 2021-2026, si dhe vizionin dhe misionin e Universitetit.

Komisioni do të trajtojë:

- Shqyrtimin dhe propozimin e ndryshimeve në kurrikula.

- Zhvillimin dhe përditësimin e udhëzimeve për programet e studimit.

- Koordinimin e programeve të reja të studimit dhe krijimin e grupeve pune ad-hoc.

- Këshillimin e Senatit Akademik për çështjet e lidhura me ofertën akademike.

Kjo risi, me përbërje të barabartë midis stafit dhe studentëve nga UBT dhe Universiteti BOKU i Vjenës (50%-50%), është eksperiencia e parë e këtij lloji në Shqipëri, duke u kthyer në një garanci për suksesin e reformës UBT-BOKU 2030

*Puna për transformimin e Universitetit Bujqësor të Tiranës vazhdon...*



## Të rinjtë, kundër “rrymës” në tregun e punës - BB: Vetëm 15% e të diplomuarve mbarojnë degët që kërkon biznesi

Shqipëria ka bërë përpjekime të rëndësishme në zgjerimin e aksesit në arsimin e lartë, por ndërsa numri i studentëve që diplomohen nga institucionet e arsimit të lartë është rritur, ekziston një dis-

avancuara të Evropës.

Banka Botërore sugjeron që për të siguruar që arsimit të lartë të kontribuojë në mënyrë efektive në rritjen ekonomike, Shqipëria duhet të përqendrohet në përmirësimin e cilësisë

duke promovuar të mësuarin ndërdisiplinor dhe duke rritur pjesëmarrjen e grupeve të nënpërfaqësuar, arsimit STEM mund të kontribuojë ndjeshëm në përparimin ekonomik dhe shoqëror.

Pavarësisht përpjekimeve të rëndësishme, cilësia e arsimit në Shqipëri mbetet ende nën kërkesat e tregut. Anketat me bizneset tregojnë se mungesa e fuqisë punëtore të kualifikuar është një pengesë e rëndësishme për bizneset.

Prandaj, sugjerohet se është thelbësore të harmonizohen rezultatet arsimore me nevojat e tregut të punës, duke siguruar që të diplomuarit të zotërojnë aftësitë e kërkuara nga punëdhënësit. Duke mësuar nga shembujt e suksesshëm të vendeve të tjera, mund të adoptohen praktikat më të mira për të mbushur këtë hendek.

Raportit ekonomik i Bankës Botërore për Rajonin e Evropës dhe Azisë Qendrore, nënvizon rolin thelbësor të arsimit të lartë në nxitjen e rritjes ekonomike dhe zhvillimin e inovacionit në të gjithë rajonin, përfshirë edhe Shqipërinë.



**TË RINJTË, KUNDËR “RRYMËS” NË TREGUN E PUNËS**  
BB: VETËM 15% E TË DIPLOMUARVE MBAROJNË DEGËT QË KËRKON BIZNESI

balancë e theksuar mes fushave të studimit.

Në këtë konkluzion del Banka Botërore, ku sipas të dhënave të publikuara së fundmi, më pak se 15 për qind e të diplomuarve në Shqipëri janë nga programet STEM të cilat përfshijnë shkencë, teknologji, inxhinieri, matematike, krahasuar me norma që janë dyfish më të larta në ekonomitë e

dhe rëndësisë së arsimit.

Sipas Bankës Botërore, në veçanti, arsimimi në degët shkencë, teknologji, inxhinieri, matematike (STEM) në arsimin e lartë është jetësor për zhvillimin e një force pune të kualifikuar, nxitjen e inovacionit dhe adresimin e sfidave globale.

Ky institucion vlerëson se duke integruar këto aftësitë,

## “Legalizimi i pronave, afati 2028 është i arritshëm” - Rama: Ndhimë nga teknologjia. Rusi: Vetëm 2.9% e kërkesave, të shqyrtuara


Afatet për përfundimin e proceseve që lidhen me legalizimin e pronave janë të arritshme, sipas kryeministrit Edi Rama.

Gjatë tryezës “Garantimi i së drejtës së pronës dhe lufta kundër korrupsionit në sektorin e pronave”, të Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Mirëqeverisjen, Sundimin e Ligjit dhe Antikorrupsionin Rama tha se në ndihmë të procesit është teknologjia.

Gjithsesi, dokumenti analitik i prezantuar gjatë tryezës nxjerr në pah një sërë problemesh që lidhen me shqyrtimin e kërkesave për legalizim, kompensimin e pronarëve apo me zbatimin e vendimeve të Gjykatës së Strasburgut, që lidhen me pronën.

Gjatë diskutimeve u kërkuar hartimi i akteve nënligjore

ratimi i VKM-së, që rregullon marrëdhëniet mes 2 institucio-



**“LEGALIZIMI I PRONAVE, AFATI 2028 ËSHTË I ARRITSHËM”**  
RAMA: NDIHMË NGA TEKNOLOGJIA. RUSI: VETËM 2.9% E KËRKESAVE, TË SHQYRTUARA

të ligjit “Për kadastrën” dhe “Për përfundimin e proceseve tranzitore”.

Po ashtu, u kërkuar edhe mi-

neve që menaxhojnë të drejtat pronësore, që janë Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Agjencia e Trajtimit të Pronave.

## Pronësia mbi tokën - 3 mln kartela, në proces digjitalizimi - Dokumenti, afati deri në Qershor 2026. Zgjidhen mbivendosjet

Mosmarrëveshjet për tokën, pretendimet për mbivendosje dhe infrastruktura e pamjaftueshme, paraqesin sfida të vazhdueshme për menaxhimin

e numrit të total të zonave kadastrale të përfundojë deri në qershor 2026, dhe përqindja e zonave kadastrale të mbetura të papërfunduara deri atëherë do

Referuar dokumentit, regjistrimi fillestar në Republikën e Shqipërisë ka filluar në vitin 1994, ka gjithsej 4,076,000 kartela, dhe në bazën e të dhënave të ASHK-së deri më 31 maj 2024 janë përfshirë 2,703,935 kartela digjitale, por nga ky numër, vetëm 1 milionë kartela digjitale (24%) janë plotësisht të digjitalizuara, dhe numri i mbetur prej rreth 1,7 milionë kartelash (42%) do të ridigjitalizohen, sepse gjatë viteve janë bërë transaksione të reja manuale, por nuk janë pasqyruar në këto kartela ekzistuese të digjitalizuara.

Nevojitet gjithashtu digjitalizimi i 1,372,065 kartelave shtesë (34%), të cilat ende



efektiv të tokës, tërheqjen e investimeve, nxitjen e rritjes ekonomike.

Qeveria ka marrë angazhimin për të adresuar këto sfida, dhe miratimi i një Udhërrëfyesi gjithëpërfshirës për të siguruar planifikimin e politikës së digjitalizimit dhe proceseve përkatëse për kadastrën është një hap që do të rrisë transparencën dhe do të lehtësojë shërbimet shtetërore të kadastrës.

Referuar dokumentit të politikës “Agjenda Kombëtare e Reformave 2024-2027” në kuadër të instrumentit të BE “Faciliteti për reforma dhe rritje për Ballkanin Perëndimor”, botuar në Fletoren Zyrtare, territori i Shqipërisë është i ndarë në 3058 zona kadastrale, ku për 2763 zona kadastrale (ose 90% të totalit të zonave kadastrale), procesi i regjistrimit fillestar ka përfunduar dhe për 295 zona kadastrale nuk ka përfunduar ende.

Qeveria parashikon që 95%



të jetë më pak se 5% .

Sipas dokumentit, për ato zona kadastrale, ku ka përfunduar regjistrimi fillestar, po bëhet digjitalizimi i kartelave të pronave dhe skanimit i titujve të pronësive. Kjo konsiderohet e nevojshme, sepse një pjesë e konsiderueshme e dokumentacionit për këto zona kadastrale është përgatitur manualisht dhe titujt e pronësive depozitohen fizikisht në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës.

nuk i janë nënshtruar procesit të digjitalizimit. Prandaj, janë gjithsej 3,076,000 kartela (76%), të cilat pritet të përfundojnë në deri në Qershor 2026.

Qëllimi kryesor është të arrihet reduktimi i vonësve kohore të shërbimeve kadastrale, rritja e efikasitetit, ofrimi i shërbimeve nga Agjencia e Kadastrës, duke marrë masa kundër korrupsionit dhe mitëmarrjes.

## Ngrohja globale 'ka ndërhyrë' në punët e bujqësisë! Fermerët e mbjellin grurin në dhjetor, një muaj përtej afatit

Ngrohja globale po dikton dhe punët e bujqësisë. Sezoni i mbjelljes së grurit është shtyrë me një muaj, thotë agronomi Ladi Pashaj në Fier. Sipas tij fermerët, tashmë duhet të bëjnë më shumë kujdes për teknologjinë dhe farën në mënyrë që t'i përshtaten ndryshimit të klimës

Mbjellja e grurit në fushat e Fierit, historikisht është bërë ndërmjet muajve tetor-nëntor, ndërsa këtë vit është shtyrë me

globale, thotë për Report tv, agronomi Ladi Pashaj, specialist në Drejtorinë e Bujqësisë.

"Në rrethin e Fieirit janë

Për të marrë rendiment të lartë, fermerët duhet të kujdesen tani për teknologjinë dhe farën, thotë agronomi, duke i këshilluar ta blejnë farën në pikat e licensura.

"Duhet të kenë parasysh plehrimin bazë, plugimin, frëzimin. Duhet të theksoj se farë është e rëndësishme. Ata mbajnë farë nga gruri i vet, por duhet ta blejnë në pikat e licensuara se kanë farë të mrekullueshme", tha Pashaj.

Ndërsa fermerët ankohen për çmimet e shtrenjta të pesticideve e farërave ndaj detyrohen të mbjellin grurin që kanë ruajtur vetë nga sezoni i kaluar.

"Çmimet janë të larta plehu nitrati ureja. Shitet me 25 mijë lek kuintali. Ne s'dalim asgjë, shteti ska vënë dorë fare", tha fermeri Sokrat Dhima.

Rajoni i Fierit është ndër kultivuesit kryesor të grurit në vend, me një sipërfaqe prej 11 mijë hektarësh.



afro një muaj. Fermerët kanë nisur mbjelljen në gjysmën e dytë të nëntorit me shpresën se do ta përmbyllin procesin në 10 ditëshin e parë të dhjetorit. Shkak është bërë ndryshimi i klimës, efekt i ngrohjes

mbjellë 1500 ha ose 15 përqind e sipërfaqes totale prej 11 mijë hektarësh. Vazhdon të mbillet dhe duke qene se kemi një ngrohje globale do shkojë deri në 10 ditëshin e parë të dhjetorit", u shpreh Pashaj.

## Tregtimi i bimëve medicinale, prodhimi i ulët rrit çmimin

Sasia më e ulët e prodhuar me bimë medicinale këtë vit, ka bërë që çmimi i tregtimit të

dëllinjë e zezë, mollë e egër, qumështore e rrënjë qumështore si dhe mëllagë e bardhë

pasi sasia e prodhimit nuk ishte ajo që pritej", tha Çibuku.

Grumbulluesit dhe tregtuesit e këtyre bimëve ju këshillojnë fermerëve të rinj që t'i dedikohen këti sektori pasi tregu i shitjes është i garantuar dhe të ardhurat që sigurohen janë mëse të kënaqshme.

Bimët mjekësore të kultivuara në Qarkun Korçë eksportohen të papërpunuara, ndërsa mund të përdoren në industrinë ushqimore për çajra bimorë, në përgatitjet ushqimore të ndryshme, në formën e erëzave për gatim, si ekstrakte për vajra esenciale, apo në industrinë e pijeve, produkteve të shëndetësisë, kozmetikës dhe parfumeve.



tyre të pësojë rritje. Fermeri Gjergji Çibuku thotë se në Qarkun Korçë këtë vit është prodhuar më tepër

të cilat shkojnë për tregun evropian.

"Këtë vit është kultivuar shumë pak. Çmimet janë rritur

## Dita e Maleve, Kumbaro: Angazhim për zhvillimin e ekoturizmit

Dita Ndërkombëtare e Maleve, e cila u shpall nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së më 11 dhjetor të vitit 2003 dhe vuri në dukje nevojën e ndërgjegjësimit të vazhdueshëm mbi rëndësinë e maleve dhe zhvillimin e qëndrueshëm të mjedisit të tyre për të ruajtur cilësinë e jetës së njerëzve.

Ministrja e Turizmit dhe Mjedisit, Mirela Kumbaro, nëpërmjet një postimi në rr-

jetet sociale thekson se këtë ditë ia kushtojmë maleve "si thirrje për të kujtuar rëndësinë e tyre në ruajtjen e balancave të natyrës dhe mirëqenien e komuniteteve që jetojnë në to".

Kumbaro nënvizon me tej se "këtë vit Ditën e Maleve e kremtojmë edhe me rregulloren e re "Për Standardizimin dhe Administrimin e Shtigjeve Turistike" që bashkon angazhimin institucional me për-

pkjetet e guidave lokale për zhvillimin e ekoturizmit dhe ruajtjen e qëndrueshmërisë".

Dita Ndërkombëtare e Maleve rrit ndërgjegjësimin për kërcënimet me të cilat përballen. Ruajtja e tyre është faktori kyç për zhvillimin e qëndrueshëm. Për shkak të ndryshimeve klimatike dhe mbishfrytëzimit, malet janë nën kërcënim. Ruajtja e maleve është një faktor vendimtar.

## Platformë e dedikuar për mbështetjen e investitorëve, AIDA mbyll me sukses nismën "Investors Support Days"

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve franceze, austriake dhe hungareze.



(AIDA) ka përmbyllur me sukses nismën "Investors Support Days", një platformë e dedikuar për mbështetjen dhe fuqizimin e investitorëve vendas dhe të huaj.

Ky aktivitet synoi në krijimin e urave të reja të bashkëpunimit, të lehtësojë procesin e investimeve dhe të promovojë potencialet e Shqipërisë në sektorë kyç si turizmi, energjia, bujqësia dhe teknologjia.

Gjatë muajve Tetor-Nëntor në bashkëpunim me MEKI, MF, MIE, AKPA, AKBN, AIC pranë AIDA u zhvilluan tryezat e rrumbullakëta me kompanitë gjermane, italiane, turke, greke,

Përveç institucioneve të qeverisjes qendrore, kjo iniciativë pati dhe prezencën e Ambasadës së Gjermanisë, Italisë, Turqisë, Greqisë, Francës, Austrisë dhe Hungarisë.

Gjithashtu pjesë e saj ishin dhe Dhoma Gjermane e Industrisë dhe Tregtisë në Shqipëri (DIHA), Dhoma Italiane e Tregtisë, Confindustria, MUSIAD, Shoqata Greke e Biznesit në Shqipëri si dhe Advantage Austria.

Ne këtë tryezë morën pjesë një total prej 120 kompanish. Për problematikat e raportuara, AIDA po i ndjek me prioritet së bashku me institucionet përkatëse, deri

në zgjidhjen përfundimtare.

Në takimin përmbyllës, drejtuesit e AIDA-s theksuan rëndësinë e një klime miqësore ndaj investimeve, duke prezantuar reformat e fundit ligjore dhe masat mbështetëse të ofruara nga qeveria. Përfaqësuesit e biznesit patën mundësinë të ndanin përvojat dhe pritshmëritë e tyre, ndërsa diskutimet praktike ndihmuan në identifikimin e zgjidhjeve konkrete për sfidat e hasura.

"Investors Support Days është një dëshmi e përkushtimit tonë për të mbështetur investitorët dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm të vendit. AIDA do të vazhdojë të jetë një partner i besueshëm në çdo hap të udhëtimit të tyre," u shpreh drejtori ekzekutiv i agjencisë.

Me një pjesëmarrje të gjerë dhe interes të shtuar për projekte të ardhshme, nisima konfirmoi potencialin e Shqipërisë si një destinacion tërheqës për investime. Investors Support Days shënon një hap përpara në promovimin e zhvillimit ekonomik dhe tërheqjen e investimeve të reja si dhe ri-investimet nga kompanitë e huaja prazente ne vend.

## Mazniku në komisionin e Posaçëm Antikorrupsion: Duhet të lehtësohet regjistrimi i pronave të bashkive

Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor, në fjalën e mbajtur në komisionin

dhe unë mendoj që duhet që nga pikëvështrimi administrativ i mënyrës se

ar," u shpreh Mazniku.

Po ashtu, Ministri Mazniku foli për ligjin e ri të bashkëpronësisë që prek hapësirat e përbashkëta duke e vënë theksin te nevoja që kanë këto prona të mirëmbahen.

"Kemi qartësi shumë të madhe për ato që janë prona private, gjithashtu e kemi të qartë se çfarë pronë publike që është e të gjithëve, por kur hyjmë në diskutimin e pronave të përbashkëta që është një sipërfaqe shumë e madhe prona, kjo është e pavlerësuar siç duhet", tha Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor.

Ligji i ri që po harton qeveria sipas Maznikut ndihmon në një seri elementesh që kanë të bëjnë me mënyrën si regjistrohet prona, si disponohet, si ndryshohet etj.



e Posaçëm të Antikorrupsionit, theksoi punën që duhet bërë për të lehtësuar procedurën që bashkitë të kenë mundësi të regjistrojnë pronat që i kanë të tyre.

"Pjesa më e madhe e pronave janë të paregjistruara në emër të bashkive

si regjistrohen pronat tek mbështetja teknike që bashkitë të regjistrojnë pronat, kemi nevojë që të gjitha palët të bëjmë më shumë për të pasur mundësi që bashkitë, si fillim t'i regjistrojnë pronat dhe ta kenë një proces të lehtësu-



SHOQATAT ANËTARE

AVALB FEDINVEST BKFSH EKR IBMA HABA AOA UPM LEAA ADAMA ABA SHGF ALBAFLOR

SHKPVF RKUK SVP MSHKM BIOADRIA PPAM SHT UOTSH KEA BIOPANT ADAD PSN

KËSHILLAT RAJONALE

TIRANA DURRESI FIERI ELBASANI SHKODRA DIBRA

LEZHA GJIROKASTRA KORÇA BERATI VLORA KUKESI



Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar

[www.kashalbania.org](http://www.kashalbania.org)

Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar





# KREDI E SHPEJTË MIKRO

PËR ÇDO QËLLIM BIZNES APO INDIVID

**KREDI MIKRO**

deri në **2,500,000** LEKË



**FED**  
invest 

**GJITHMONË**  
**FINANCË SOCIALE**

## BUJQËSI

## Projekti me BB, Denaj: Krisim standardet e eksportit dhe marketingut të vajit të ullirit

Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Anila Denaj zhvilloi një takim me misionin e Bankës Botërore ku u diskutua mbi projektin "Qëndrueshmëria ndaj Klimës dhe Zhvillimit të Bujqësisë".

Ministrja bëri të ditur se projekti kap një vlerë rreth 65 milionë euro dhe synon përmirësimin dhe modernizimin e sistemeve të ujitje-kullimit.

Po ashtu, Denaj theksoi se përmes këtij financimi do të krijohen "Clusteret" për vaj ulliri dhe fruta-perime për të rritur standardet e eksportit dhe marketingut të vajit të ullirit si një produkt "Premium".

"Projekti synon krijimin e qendrave ushqimore për grumbullimin, përpunimin, paketimin dhe shpërndarjen e produkteve bujqësore për tregje si "HoReCa",

si dhe dixhitalizimin e bujqësisë për përmirësimin e prodhimit bujqësor", u shpreh Denaj.

kontrollit kufitar.

Denaj nënvizoi gjithashtu se ky projekt kontribuon drejt bu-



Po ashtu, ministrja theksoi se përmes këtij projekti synohet rritja e sigurisë ushqimore, si dhe modernizimi i pikave të

jqësisë së qëndrueshme dhe moderne, duke rritur produktivitetin, cilësinë dhe konkurrueshmërinë e prodhimeve "Made in Albania".

## Demo: Vaji i ullirit i prodhuar në Berat eksportohet në Gjermani

Produktet shqiptare si ulliri, vaji i ullirit dhe vera, të prodhuara në Berat tashmë po eksportohen në Gjermani.

Lajmi u bë i ditur nga kryetari i bashkisë së Beratit, Ervin

dhe Gleni Meta, drejtor i blerjeve të një kompanie novatore në Gjermani për futjen e produkteve bujqësore të një cilësie të lartë dhe bazuar në praktika të qëndrueshme bujqësore.

shqiptare si ulliri, vaji i ullirit dhe vera.

"Prodhuesit e vajit të ullirit "Ledianës dhe Arbërit" në Bilçë janë një nga eksportuesit e parë që kanë filluar bashkëpunim me këtë kompani gjermane dhe produktet "Made in Albania, Berat", po ashtu vera nga zona Malinat, Berati është futur në portofolin e kësaj kompanie dhe këto produkte po eksportohen në disa vende të BE-së", theksoi Demo.

Kryebashkiaku Demo u shpreh se "pëlqyeshmëria e lartë e produkteve nga konsumatori evropian ka hapur mundësinë e bashkëpunimit me disa distributorë të rëndësishëm në Gjermani".

"Promovimi i produkteve që vijnë nga rajoni i Beratit dhe nxitja e zhvillimit të mëtejshëm të agrobiznesit, përmes politikave lokale është në fokusin e bashkisë", tha Demo.



Demo, i cili priti në një takim Sergej Schwab, drejtor i shitjeve

Demo tha se në fokusin e kësaj kompanie janë produktet

## Rishikohen programet e punësimit - Si do të përshtatet oferta me kërkesat që kanë të papunët

Qeveria do të rishikojë programet e punësimit me qëllim integrimin të treg të atyre që janë të papunë.

Në dokumentin e politikës "Agjenda Kombëtare e Reformave 2024-2027 në kuadër të instrumentit të BE, parashikohet ofrimi i programeve aktive të tregut të punës, të reja dhe të diversifikuara, që synojnë mbështetjen për punëkërkuessit që përfitojnë ndihmë ekonomike, punëkërkuessit e papunë afatgjatë dhe punëkërkuessit e papunë afatgjatë me arsim bazë/pa arsim paraprak deri në Qershor 2025.

Nga kjo politikë synohet rritja e numrit të punëkërkuessve të papunë të regjistruar në programet aktive të tregut të punës në 8% deri në qershor 2026.

e numrit të regjistrimit të punëkërkuessve në zyrat e punësimit në 60% të totalit të të papunëve si dhe rritja e numrit të punëkërkuessve të papunë në formimin profesional në 20% të totalit të punëkërkuessve të papunë deri në dhjetor 2026.

Duke ofruar mbështetje të diversifikuar të përshtatur për nevojat e këtyre grupeve, politika synon të rrisë punësueshmërinë e tyre dhe shanset për të gjetur punësim të qëndrueshëm.

Gjatë vitit 2023, numri i

përgjithshëm i punëkërkuessve ishte 76.580, nga të cilët 41.533 ishin gra, 26.909 merrnin ndihmë ekonomike, 6.870 ishin romë dhe egjiptianë dhe 1.607 ishin persona me aftësi të kufizuara.

Numri i punëkërkuessve të papunë që përfituan nga Programet Aktive të Tregut të Punës gjatë vitit 2023 arrin në 10.017 individë, nga të cilët 2.635 kanë përfitur nga programet e nxitjes së punësimit dhe 7.382 nga kurset e formimit profesional.



## "Festa e Mandarinës", Kote: Nis projekti për vaditjen me presion në 2200 ha tokë, përmirëson rendimentin

"Festa e Madarinës" në Konispol është kthyer në një traditë të përvitshme tashmë.

Fermerët, banorë të zonës, por edhe shumë të ftuar të tjerë vendas dhe të huaj, festojnë thajse çdo fund nëntori sezonin e vjeljes së mandarinave, përmes aktiviteteve të ndryshme për fëmijë, vizita në plantacionet dhe fabrikat e përpunimit në fshat, panair me produkte lokale, muzikë e ushqime tradicionale etj.

Në festën e organizuar me këtë rast në Konispol, që është e mirënjohur tashmë për plantacionet me mandarina dhe prodhimin cilësor të këtij produkti, "Made in Albania", ishte i pranishëm edhe zv.ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Dhimitër Kote.

Kote tha se, në mbështetje të këtij sektori në Konispol do të nisë zbatimi i projektit për sistemin e ujitjes me presion.


"Përmirësimi i vaditjes në mbi 2200 ha tokë bujqësore do të rrisë qëndrueshmërinë dhe rendimentin e prodhimit", u shpreh Kote.

"Festa e Mandarinës" synon të promovojë prodhimin vendas të mandarinave dhe kjo festë është shembulli konkret që flet për suksesin e prodhimit dhe të eksportit në rritje të mandarinave.

Sipas MBZHR-së mandarinat e zonës së Konsipolit vlerësohen të një cilësie të lartë dhe prodhim pa pesticide të dëmshme dhe kjo bën që eksportet e mandarinave të preferohen gjithnjë e më

shumë në tregjet e huaja, kryesisht në Kosovë, Maqedoninë e

jqësinë shqiptare, ku angazhojnë në punë pothuajse të gjithë



Veriut, Poloni e Çeki, por dhe në vende të tjera të Europës Lindore e të Ballkanit.

Ndërkohë që plantacionet me mandarina dhe agrume të tjera në Konispol janë kthyer në një model investimi në bu-

banorët e bashkisë Konispol, teksa gjenerojnë punësim edhe për banorë nga zona të tjera të Ksamilit, Delvinës, ato ndikojnë drejtpërdrejtë edhe në rritjen e të ardhurave për ekonomitë fermerë.

## Verërat shqiptare prezantohen në edicionin e 3-të të Panairit "Wine Vision by Open Balkan 2024"

Shqipëria përfaqësohet denjësisht nga 7 kantina, në edicionin e tretë të panairit "Wine Vision", që po zhvillohet në Beograd, Serbi, ku marrin pjesë 38 vende nga e gjithë bota.

Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Anila Denaj,

in Albania" në rajon dhe më gjerë, konfirmon cilësinë, traditën tonë unike dhe vëmendjen e shtuar për verërat shqiptare jashtë vendit", tha Denaj.

Ministrja vlerësoi se ky panair nxit forcimin e bashkëpunimit rajonal, eksportin e

të Maqedonisë së Veriut dhe Serbisë, nisur nga bashkëpunimi rajonal midis vendeve të Ballkanit të Hapur.

Shqipëria përfaqësohet në Panairin "Wine Vision by Open Balkan 2024", në Serbi, me Agjencinë Kombëtare të Turizmit. Në ditën e parë të Panairit, morën pjesë në ceremoninë e hapjes, ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural Anila Denaj, drejtoreja e përgjithshme e Agjencisë Kombëtare të Turizmit, Zana Çela dhe ambasadori i Shqipërisë në Serbi, Bardhyl Canaj, të cilët vizituan nga afër standat e bizneseve shqiptare pjesëmarrëse në këtë panair.

Në një njoftim për shtyp AKT bën të ditur se, mbi 800 verëra nga Serbia, Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut do të garojnë në Konkursin e Open Balkan Wine Trophy 2024.

Në Panairin "Wine Vision by Open Balkan 2024" prezantohen varietete të shumëllojshme vere dhe produkte të tjera ushqimore në 650 stenda, të tëra për t'u eksploruar.



teksa publikoi në rrjete sociale pamje nga stenda e Shqipërisë në panair, vlerësoi markat shqiptare të prodhimit të verës.

"Promovimi i produkteve autentike shqiptare "made

verërave shqiptare, si dhe prezanton shijet unike shqiptare në tregjet ndërkombëtare.

"Confluence of Culture" është tema e stendës prezantuese të Shqipërisë, vendosur në kra-

## BUJQËSI

## Sivjet më pak studentë të bujqësori - Rektori: Të ndryshojë mendësia, vendi i punës është i garantuar

Ky vit akademik shënoi një ulje të numrit të studentëve në vitet e parë bachelor, për Universitetin Bujqësor të Tiranës.

Por pavarësisht kësaj, falë programeve që ky universitet ofron për rektorin Fatbardh Sallaku të rinjtë marrin një zinat që ka rëndësi jetike.

"Universiteti bujqësor nuk vuan për numër studentësh, ekonomia shqiptare ka nevojë për këto lloj profesionesh. Ky vit pati një rënie të vogël në numër regjistrimesh, ndoshta e papritur për disa programe që ne i konsiderojmë si më të rëndësishme". Kryesisht janë degë që ndoshta kanë një perceptim të gabuar nga të rinjtë pasi mendojnë se duke studiuar në këtë degë do të punojnë në ferma", tha ai.

Rektori Sallaku thekson se për shumë nga degët tregu i punës është i garantuar.

"Sot që flasim në strukturat e Ministrisë së Bujqësisë janë mbi 200 vende pune të lira",

shtoi ai.

Janar i vitit do të ofrojë një paketë të re akademike për studentët që ndjekin studimet pranë këtij kampusi universitar.



## Këshillimi i karrierës, arritjet dhe sfidat e zbatimit të modelit në Shqipëri

Këshillimi i karrierës kontribuon në zgjedhje më të

në përmirësimin e përputhshmërisë mes kërkesës dhe ofer-

një konferencë, që mbledhi së bashku ekspertë të fushës për të trajtuar arritjet dhe sfidat e zbatimit të modelit të këshillimit të karrierës në Shqipëri.

"Problematikë tipike për Shqipërinë, por edhe vendet e rajonit e më gjerë, është mungesa apo mospërputhja e aftësive me tregun e punës. Orientimi në karrierë është gjithashtu shumë i rëndësishëm për adresimin e këtyre dy problematikave," u shpreh zv.ministria e Ekonomisë, Olta Manjani.

Konferenca pati diskutime edhe mbi rolin e medias në orientimin e karrierës të të rinjve, për t'i fuqizuar ata drejt vendimmarrjes së informuar për zgjedhjet profesionale.



mira sa i takon edukimit dhe punësimit, si dhe ndihmon

tës për punë.

Për këtë temë u zhvillua

## Mbarështimi i gjelit të detit - Për fermerin Toma, kostoja e rritjes së tyre është e lartë

Ky është 74 vjeçari Ndoc Toma nga fshati Dajç i Lezhës, i cili prej 15 vitesh merret me mbarështimin e gjelave të detit. Ndoci tregon se për të mbarështuar një gjel duhen 9 muaj, ndërsa kostoja për ti rritur është e lartë dhe se ka një mund të madh.

Zona e Mabës dhe Dajçit në Lezhë njihen për gjelat cilësor të rritur në mënyrë organike, çmimi i të cilëve këtë vit varion 1000-1200 lekë kilogrami për një gjel.

Fermerët në këtë zonë çdo fund vit, në prag festash nisin shitjet e shpendit tradicional. Fshatrat Mabë dhe Dajç, vazhdojnë të jenë pa një treg dhe

gjeli i detit shitet buzë aksit nacional Shkodër-Lezhë me

shpresën se udhëtarët mund ta blejnë atë.



## "Gruaja dhe mjedisi"- Aktivitet në kuadër të 16-ditëve të aktivizmit kundër dhunës me bazë gjinore

16 ditët e aktivizmit kundër dhunës me bazë gjinore erdhen ndryshe këtë herë. Aktiviteti u titullua "Gratë dhe mjedisi". Sa afër dhe larg është gruaja nga mjedisi, çfarë e bashkon dhe ndan atë?

Gra të zonës Shirokë-Zogaj përmes shembujve të jetës së tyre treguan edhe një herë që forca e gruas thyen çdo barrierë mendore e fizike.

Vajza dhe gra, eksperte të mjedisit, punonjëse sociale, me rol të rëndësishëm në shoqëri dhe institucione lokale tekta zgjedhën të eksplorojnë me varkë liqenin e



Shkodrës, ndanë bashkë eksperiencën mbi rolin e grave

jo vetëm në familje, por edhe mjedis.

## Rritet kërkesa për produktet vendase, banorët: Çmimet janë të përbalueshme

Në tregun agro-ushqimor të qytetit të Kukësit numri i blerësve është i lartë këtë periudhë.

Ajo çfarë mbizotëron në tezgat e tregut janë produktet vendase nga fshatrat. Më së shumti blerësit konsumojnë frutat dhe perimet e sezonit.

Për sa i përket çmimeve të produkteve, konsumatorët shprehën se janë të përbalueshme dhe prodhimet vendore janë tepër cilësore.

"Konsumojmë frutat dhe perimet ende të fshatit. Janë bio. Janë prodhime të stinës," shprehën ata.

Tregu i qytetit është i mbushur me blerës e kjo vjen

edhe për shkak të afrimit të festave të muajit dhjetor.



## Këshillimi Smart - Mbjellja e domates në serra

Planifikimi i mbjelljeve të reja në sera - Dhjetor 2024

Shqipëria ka një potencial të madh për prodhimin e domateve në sera, duke marrë parasysh disa faktorë favorizues të rëndësishëm si klima e favorshme, tokë e përshtatshme, traditë në kultivim, kërkesë të tregjeve rajonale dhe europiane, akseset portuale dhe tokësore për eksport.

Kultivimi i domates në sera është një mënyrë efektive për të prodhuar me cilësi të lartë në kushte mjedisore të kontrolluara. Më poshtë paraqitet një udhëzues për kultivimin e suksesshëm të domateve në serë:

### 1). Planifikimi dhe Përgatitja

Përzgjedhja e varietetit. Tregoni kujdes në përzgjedhjen e varietetit të domates të përshtatshme për kultivimin në sera, bazuar në kërkesën e konsumatorit të brendshëm dhe të jashtëm.

Marrëveshje me fidanishtet. Kontaktoni fidanishtet dhe bëni porosinë e fidanëve të përzgjedhur në kohë, duke respektuar kartën teknologjike.

2). Përgatitja e tokës dhe plasmasit për mulcerim Lloji i tokës. Bëni analizat e

tokës për të përcaktuar skemën e plehimit. Përdorni tokë të drenazhuar mirë me një pH midis 6.0 dhe 6.8.

Sterilizimi. Sterilizoni tokën për të eliminuar dëmtuesit dhe sëmundjet.

Lëndët ushqyese. Përdorimi i plehut organik të kompostuar dhe plehra të ekuilibruar (raporti NPK prej 5-10-10 është i zakonshëm për domatet).

3). Mbjellja e fidanëve Fidanët. Mbillni kur të kenë të paktën 4-5 gjethe të shëndetshme.

Thellësia e mbjelljes së fidanit. Mbilleni fidanin më thellë se në fidanishite, deri në grupin e parë të gjetheve për të nxitur rritjen e rrënjëve.

Mbështetëset/spangot varëse. Vendosni mbështetëset për të drejtuar bimët lart dhe për të kursyer hapësirë.

4). Kushtet e Mjedisit Temperatura. Ruajtja e temperaturës 21-24°C gjatë ditës dhe 13-18°C gjatë natës.

Lagështia. Mbani lagështinë relative midis 60-70% për të parandaluar sëmundjet.

Drita. Siguroni 12-16 orë dritë çdo ditë.

Ventilimi. Përdorni ventilatorë për të siguruar qarkullim të mirë të ajrit dhe për të parandaluar sëmundjet kërpudhore.

5). Ujitje dhe Plehërim Fertigimi. Përdorni ujtitje me pika me sistem adekuat fertigimi për të ujitur thellë dhe vazhdimisht. Shmangni lagështimin e gjeteve.

Plehërimi. Aplikoni plehra rregullisht; filloni me plehra të pasura me azot gjatë rritjes vegetative, pastaj kaloni në fosfor dhe kalium gjatë lulëzimit dhe frutave.

### 6). Menaxhimi i dëmtuesve dhe sëmundjeve

Dëmtuesit e zakonshëm. Kujdesuni për afidet, krahëbardhën etj. Përdorni teknika të menaxhimit të integruar të dëmtuesve (IPM) ose kontrollit/insektit biologjike.

Sëmundjet. Parandaloni sëmundjet, mykun pluhur dhe vyshkjen e fusariumit duke ruajtur higjienën dhe ajrosjen e duhur.

Higjiëna. Hiqni menjëherë bimët ose mbeturinat e infektuara.

## FINANÇIM

## Çelet thirrja për grantet 2025, Kumbaro: 300 mln lekë për mbështetjen e startup-eve

Ministrja e Turizmit dhe Mjedisit, Mirela Kumbaro tha se për të rinjtë në të gjithë vendin është hapur thirrja e granteve 2025 për startup-et shqiptare.

“Një mundësi që mbështet të gjithë të rinjtë që ta kthejnë frymëzimin e tyre në një projekt, me inkurajimin e veçantë për të rinjtë e Gjirokastrës që kanë krijuar shembuj suksesi përmes startupeve, ta vazhdojnë më tej këtë risi duke aplikuar deri më 30 dhjetor”, tha Kumbaro në një postim në Facebook.

Ministrja theksoi se “qeveria shqiptare po vendos në dispozicion 300 milionë lekë për të fuqizuar inovacionin dhe sipërmarrjet e reja, prandaj lexoni me vëmendje kriteret dhe çoni përpara idenë tuaj të biznesit falë kësaj mbështetje”.

Programi për mbështetjen e kompanive startup dhe lehtësuesit e startup-eve nëpërmjet granteve dhe masave mbështetëse 2025 është krijuar nga qeveria shqiptare për të stimuluar sipërmarrjen inovative duke ofruar financim për

kompanitë startup më prem-tuese shqiptare.

Financimi i dhënë nga

85% të kostove për aplikantët fitues në fazën e dytë; Faza e Validimit dhe 75% të kos-



qeveria shqiptare në kuadër të mbështetjes me grante 2025, do të mbulojë 100% të kostove totale të projektit për aplikantët fitues në fazën e parë. Faza e Ndërtimit të Konceptit;

tove për aplikantët në fazën e tretë; Faza e Zgjerimit dhe Ndërkombëtarizimit. Afati i implementimit të projekteve për vitin 2025 do të jetë afërsisht 9 muaj.

## Skema e Investimeve, 305 aplikime për mekanikë bujqësore

Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Anila Denaj

janë për mekanikë bujqësore. Në një intervistë tele-

mund të shkojë 30 deri 36 mijë euro ku 50 % financohet grant nga Skema e Investimeve. Ndërsa pjesa tjetër do të paguhet nga fermeri, fond të cilin fermeri mund ta marrë kredi në bankë duke përdorur Fondin e Garancisë Sovrane ku shteti mbështet 80% të kolateralit.

Ministrja bëri të ditur se gjithashtu është funksional Fondi i Garancisë Sovrane me BERZH-in që ka 50 milionë euro të papërdorura.

Ajo informoi se një instrument tjetër për financimin e fermerëve është dhe fondin me kfw gjermane që mbështet me grante startup-et.



bëri të ditur se, nga 404 aplikime në Skemën Kombëtare të Investimeve 2024, 305 kërkesa

vizive, Denaj shpjegoi se për mekanikën bujqësore vlera mesatare për fermerë

## Panairi i gjelit të detit, promovim produkteve lokale të Peqinit

Panairi i Gjelit të Detit, në Peqin rikthehet këtë fundvit, duke sjellë në qendër të vëmendjes traditën shumëvjeçare të mbarëshimit të këtij shpendi, simboli kryesor i tryezës festive.

Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Anila Denaj, vizitoi panairin ku fermerët peqinas prezantuan jo vetëm gjelat e detit, por edhe produktet të zonës “Made in Albania”, si ullinjë e cilësisë së lartë, vajin e ullirit, perime të freskëta të stinës dhe gatime tradicionale të zonës.

Ministrja e cilësoi panairin, si takimin ku jo vetëm prezan-

tohen prodhimet lokale por që nxjerrin në pah cilësinë dhe rëndësinë e produkteve ven-



dore që janë mjaft të kërkuara nga konsumatorët vendas dhe të huaj.

## Mikrokreditë, Malaj: Shumë shpejt do të kemi një draft të kuadrit rregullator

Ministri i Financave Petrit Malaj bëri me dije se shumë shpejt do të ketë një draft të kuadrit rregullator për mikrokreditë.

Ministri Malaj theksoi se ka dy grupe teknike që po punojnë normalisht në mënyrë që të përmirësojnë kuadrin ligjor për të frenuar fenomenet që ndodhën në të shkuarën.

“Shumë shpejt do të kemi edhe një draft të kuadrit rregullativ që do të bëhet nga grupet teknike që më pas do të

kolaudohet edhe nga grupet e interesit”, tha Malaj.



## Përrjashtimet tatimore, Malaj: Asnjë ndryshim për profesionet e lira dhe biznesin e vogël deri në 2029-n

Ministri i Financave Petrit Malaj bëri me dije se nuk do të ketë asnjë rishikim të përjashtimeve tatimore për profesionet e lira dhe biznesin e vogël deri në vitin 2029.

Gjatë një konference për mediet, ministri Malaj theksoi se

profesionet e lira.

Gazetarja: FMN ka sugjeruar që të rishikohen përjashtimet tatimore ndaj bizneseve, kryesisht ndaj bizneseve të vogla që janë pa taksa dhe profesionistët e lirë, ndërkohë në strategjinë afatmesme ju e keni parashikuar

egjinë afatmesme të të ardhurave që do të të bëjmë një rishikim të të gjitha përjashtimeve tatimore apo normave të reduktuara tatimore për gjatë periudhës janar-qershor 2025. Këto përjashtime tatimore do të rishikohen në dy plane, plani i parë do të jetë nëse këto përjashtime kanë dhënë ato benefite ekonomike për të cilat u dhanë, dhe plani i dytë i rishikimit ka të bëjë më pjesën nëse përjashtimet e dhëna janë në linjë me direktivat e BE-së.

Nëse pas analizës që ne bëjmë do të vlerësojmë se përjashtime të caktuara do të duhet të qëndrojnë, sepse i kemi marrë ato benefite do të vazhdojnë të qëndrojnë dhe për ata përjashtime të cilat nuk kanë dhënë benefitet e duhura ekonomike dhe që bien ndesh edhe me direktivat e BE-së, ato do të rishikohen përkatësisht. Për pjesën e profesioneve të lira dhe biznesit të vogël besoj ka qenë i qartë edhe kryeministri, deri në vitin 2029 nuk do të ketë asnjë lloj ndryshimi”, tha ministri Malaj.



është parashikuar në strategjinë afatmesme që të bëhet një rishikim i të gjitha përjashtimeve tatimore apo normave të reduktuara tatimore përgjatë periudhës janar-qershor 2025, por nuk përfshin bizneset e vogla dhe

një gjë të tillë deri në qershor 2025. A do të ketë një rishikim para premtimit të dhënë që është vitit 2029 për bizneset e vogla dhe profesionistët e lirë?

Ministri Malaj u përgjigj se; “Kemi parashikuar në strat-

## Malaj: Sektori privat të reflektojë të njëjtin trend si sektori publik për nivelin e pagave

Ministri i Financave, Petrit Malaj në një konferencë me gazetarët, u shpreh sot në lidhje me hendekun e pagave mes sektorit privat dhe atij publik dhe aksionin që ka ndërmarrë qeveria në drejtim të informalitetit. Ministri si fillim, tha se përcaktimi i nivelit të pagave në sektorin privat rregullohet me Kodin e Punës dhe është çështje politikash që ndjekin punëdhënësit.

“Sa i përket informalitetit ne jemi në një proces që po ndiqet nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, më duhet të them që të gjitha bizneset private kanë reaguar pozitivisht në drejtim të njoftimeve që ka lëshuar Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

Së shpejti, do të kemi disa rezultate konkrete dhe unë besoj se

presioni pozitiv që po bën qeveria në aspektin e rritjes së pagave në sektorin publik, sikundër dhe lufta kundër informalitetit do të japin një rezultat pozitiv për sek-

torin privat. Sektori privat duhet të reflektojë të njëjtin trend që po ndjek sektori publik, nëse do të mbetet konkurrues në ekonominë shqiptare”, theksoi ai.



## AGROTURIZËM

## Beci: Investitorët austriakë interes për resort skish në Alpet shqiptare

Investitorët austriakë vlerësojnë potencialin për resort skish në Alpet shqiptare në qarkun e Shkodrës.

Kryetari i bashkisë së Shkodrës, Bent Beci zhvilloi një udhëtim pune në Alpe me Peter Schröcksnadel, një nga investitorët e resorteve austriake më me zë në këtë fushë, në Austri e Zvicër, si edhe zv.president i Komitetit Olimpik në Austri.

Ata u shoqëruan edhe nga presidenti i Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar, Fidel Ylli.

Ata vizituan disa pika në Shalë dhe Theth për të parë mundësinë e investimeve për pista skish.

“Një udhëtim i bukur pune

me investitorë austriakë për të vlerësuar potencialin për resort skish në Alpet magjike shqiptare në Shkodër”, u shpreh

Beci.

Ai falënderoi kreun e KOKSH, Fidel Ylli për organizimin e kësaj vizite.



## Projekt i ri ekoturistik në Korçë, Kumbaro: Rijetësimi i objekteve të së shkuarës në shërbim të turizmit dhe komunitetit

Një tjetër godinë në Korçë do të rijetësohet, për t'u vënë në shërbim të Administratës së Zonave të Mbrojtura të qarkut

një destinacion me rol edukimi për fëmijët dhe të rinjtë, me rol turistik për t'u shpjeguar turistëve se çfarë ofron qarku, por

në Parkun Tushemisht-Drilon, ku kryem jo vetëm një rikualifikim të parkut natyror, por edhe atje po merr formë një qendër e re vizitorësh si mjedis që i dedikohet kryesisht zonës së Pogradecit dhe liqenit të Pogradecit si pjesë e UNESCO-s. Kështu do të kemi shumë më tepër arsye për të ardhur në Korçë dhe për të sjellë brezin e ri në gjithë qarkun e Korçës”, tha Kumbaro.

Kryetari i bashkisë së Korçës, Sotiraq Filo u shpreh se kjo qendër do t'i shërbejë gjithë qytetit.

“Është një qendër që do të ketë shumë elementë që tek ndërgjegjësimi dhe edukimi për fëmijët, deri tek muzeu ku vizitorët mund të njihen me potencialin e zonave të mbrojtura. Besoj do të jetë atraksion më tepër që do t'i shtohet qytetit të Korçës. Falë këtij projekti,

edhe si hapësirë për të zhvilluar evente”, – u shpreh gjatë fjalës së saj Kumbaro.

Ky është një projekt i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit në kuadër të programit euro-



të Korçës dhe si qendër multifunktionale në shërbim të komunitetit.

Ministrja e Turizmit dhe Mjedisit, Mirela Kumbaro ishte e pranishme në aktivitetin e prezantimit të projektit të restaurimit arkitektonik dhe të rigjenerimit urban të hapësirave të reja të punës për Administratën Rajonale të Zonave të Mbrojtura në Korçë.

“Qarku i Korçës ka bukuri natyrore dhe kulturore. Me bashkinë e Korçës zbuluam se ka disa godina, që janë aty prej vitesh si hapësira të mbetura bosh, të pashtyrtëzuar. Mënyra më e mirë për të rentabilizuar ishte nëpërmjet një projekti të tillë që quhet “Creativity”, pra krijimtari, për të ri-jetësuar destinacione të vjetra që kanë pasur një tjetër përdorim, duke u dhënë përmes krijimtarisë arkitekturore një jetë të re. Vendosëm për t'i dhënë jetë ndërtesës që në Korçë njihet si ish-Hipoteka, jo thjesht si rezidencë për zyra për Administratën Rajonale të Zonave të Mbrojtura, por shumë më tepër se kaq, për të krijuar një hapësirë të re urbane brenda qytetit dhe qarkut të Korçës, si



pian Interreg IPA: “Industrië Kulturore dhe Kreative”.

Në vijim, ministrja Kumbaro përmendi edhe rikualifikimin e parkut natyror Drilon-Tushemisht, duke krijuar një hartë të plotë të atraksioneve ekoturistike në qarkun e Korçës.

“Kjo nuk është e para punë e tillë në qarkun e Korçës, pasi pak muaj më parë ishim në Pogradec ku treguam një punë të mirë në zonat e mbrojtura

kur ai të përfundojë, do të kemi mundësi të bëjmë një tjetër projekt për të rivalizuar ish-Shtëpinë e Pionerëve”, tha Filo.

Gjatë periudhës janar-tetor 2024 zonat e mbrojtura në gjithë Shqipërinë u vizituan nga 4,9 milionë vizitorë, ose 20% më shumë se një vit më parë, duke treguar interesin e turistëve për atraksionet natyrore dhe shtrirjen e ofertës turistike gjatë gjithë vitit.

## Festa e Verërave dhe Gështenjave, Rama: Pogradeci ju mirëpret

Promovimi i produkteve vendase është synimi kryesor i Festës së Verërave dhe Gështenjave, e cila organizohet në Pogradec.

E kthyer tashmë në traditë në qytetin e Pogradecit, kjo festë tërheq vizitorë të shumtë dhe turistë të huaj të cilët shijojnë produktet vendase.

Kryeministri Edi Rama ftoi qytetarët që në datat 6 dhe 7 dhjetor të bëhen pjesë e Festës së Verërave dhe Gështenjave, në Pogradec.

Festa e Verërave dhe Gështenjave është shndërruar tashmë në një festë të përvitshme që tërheq gjithmonë e më shumë vizitorë në qytetin juglindor të vendit.

Edhe këtë vit nuk do të

mungojnë tezgat në shërbim të të gjithë të interesuarve që dëshirojnë të tregtojnë verën e tyre apo produkte ushqimore

tradicionale, punimet artizanale etj.

Prodhimi i verës mbetet një traditë për qytetin e Pogradecit,



tradicionale. Po ashtu, bizneseve iu krijohet mundësia që të promovojnë gatimet e tyre

ndërsa verërat pogradecare në vite, kanë marrë edhe disa çmime ndërkombëtare.

## Rama: “Oda e Zjarrit” i shton jetës turistike mbrëmjen e traditës shqiptare

Kryeministri Edi Rama përcolli në rrjetet sociale lajmin për hapjen e hapësirës më të re inovative në kryeqytet, ku tradita shqiptare do të jetë kryefjalë.

“Oda e Zjarrit, një hapësirë inovative që shumë shpejt do të hapet për të sjellë në jetën turistike të vendit mbrëmjen shqiptare të traditës”, shkroi Rama.

Oda e Zjarrit është pjesë e qendrës kulturore Albanian Night.

Arkitektët kanë rindërtuar për këtë qëllim odën më të madhe të zjarrit në Shqipëri, 9 m e lartë dhe 250 m2.

Kjo hapësirë është në dispozicion të Albanian Night, mbrëmjes tradicionale shqiptare

që do të ndodhë përgjatë gjithë vitit.

Qytetarët mund të vishem me kostume tradicionale si-

kundër stafit dhe do të përjetojnë eksperiencë interaktive me këngë e valle të interpretuara live.



## Kumbaro: Standardet më të mira të mikpritjes duke rijetëzuar banesat e vjetra në Korçë

Qyteti i Korçës është kthyer në një prej destinacioneve turistike më të vizituara në Shq-

zonat karakteristike të qytetit.

Ministrja e Turizmit dhe Mjedisit, Mirela Kumbaro

mbreslënëse trashëgiminë e pasur kulturore e shpirtërore pa cenuar asnjë “gur” nga mozaiku i lagjeve historike është virtyt estetik i korçarëve mes shumë të tjerave, që tek “Vintage Boutique Hotel” është bërë me një sqimë e mjeshtëri të jashtëzakonshme”, theksoi Kumbaro.

Pronari i këtij hoteli tha se “kjo ndërtesë më parë ka qenë shtëpi e ndërtuar në 1920 me projekt italian”.

Vizitorët vendas dhe të huaj që vizitojnë Korçën kanë mundësi të orientohen lehtësisht në muzeumet, institucionet publike, parqet dhe vendet e tjera të vizitueshme në qytet.

Në çdo kohë, turistët mund të vizitojnë të gjitha atraksionet turistike, të përfshira në turin e qytetit për të cilat orientohen lehtësisht, pasi janë vendosur tabela informuese.



ipëri, që mirëpret fluks vizitorësh në çdo stinë të vitit.

Kjo ka sjellë edhe nevojën për rritjen e kapaciteteve akomoduese, duke krijuar kështu një trend në ndërtimin e bujtinave dhe hoteleve, të cilat pozicionohen kryesisht në

ndau në rrjetet sociale pamje nga një prej hoteleve më të reja të hapur në këtë qytet.

“Të ndërtuarit e folezave të ngrohta me standardet më të mira të mikpritjes, duke rijetëzuar banesat e vjetra dhe duke përcjellë në formën më







# PËRFITO

NORMAT MË TË MIRA  
TË INTERESIT



## Depozita e Artë

- Hap depozitën **36 Muaj**
- Normë interesi deri në **4.5%** në Lekë dhe **3.5%** në Euro

Skano për  
më shumë

